



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 21, datë 02.04.2026



**PËR MIRATIMIN E DHËNIES PËR ZHVILLIM TË PASURISË ME NR. 25/40, E LLOJIT “NDËRTESE”, ME SIPËRFAQE 410 M<sup>2</sup>, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8518, RRUGA “PAVARËSIA”, LAGJJA NR. 13, DURRËS, ME QËLLIM SHKËMBIMIN NË NATYRË PËR PËRFITIMIN E SIPËRFAQES NDËRTIMORE EKUVALENTE OSE MË TË MADHE SE OBJEKTI EKZISTUES**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” të ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, VKM nr.536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Durrës të Qarkut të Durrësit” e ndryshuar, Vendimit Nr. 4, datë 27.07.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës”, Vendimin Nr. 18/01, datë 21.05.2025 të Kryetarit të Bashkisë Durrës “Për miratimin e dokumentave të planit të detajuar vendor për njësinë strukturore DR\_UB\_A2\_331/18, Bashkia Durrës”, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e dhënies për zhvillim të pasurisë me nr. 25/40, e llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe 410 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale 8518, rruga “Pavarësia”, lagjja nr. 13, Durrës, me qëllim

shkëmbimin në natyrë për përfitimin e një sipërfaqe ndërtimore ekuivalente ose më të madhe se sipërfaqja e objektit ekzistues.

2. Përfitimin nga ana e bashkisë Durrës të sipërfaqes ndërtimore ekuivalente ose më të madhe se sipërfaqja e objektit ekzistues e llojit njësi shërbimi/banimi, pozicionimi i të cilave do bëhet me negociim me zhvilluesin privat.
3. Pas zbardhjes se lejes së ndërtimit dhe para fillimit të punimeve, ngarkohet kryetari i bashkisë për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin me negociim me zhvilluesin privat të sipërfaqes takuese ndërtimore që përfiton Bashkia Durrës, ekuivalente ose më të madhe se sipërfaqja e objektit ekzistues, si dhe vendndodhjen/pozicionimin e kësaj sipërfaqe, në zbatim të këtij vendimi. Detajet teknike do të përcaktohen në marrëveshjen që do të lidhet midis zhvilluesit privat dhe Bashkisë sipas legjislacionit në fuqi.
4. Miratimin e shembjes së pasurisë me nr. 25/40, e llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe 410 m<sup>2</sup>, ndodhur në ZK 8518, rruga “Pavarësia”, lagjja nr. 13, Durrës, në pronësi të bashkisë Durrës, pas miratimit të lejes për zhvillimin e ri dhe pas përfundimit të procedurave të parashikuara në këtë vendim.
5. Kontrata përfundimtare që do të nënshkruhet mes palëve, për kalimin e sipërfaqeve ndërtimore, regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe çdo shpenzim për këtë procedurë të ndjekur deri në regjistrimin përfundimtar të sipërfaqeve takuese në favor të Bashkisë Durrës, paguhet nga subjekti zhvillues “Royal – G Konstruksion” shpk.
6. Pas përfundimit të objektit, ngarkohet kryetari i bashkisë për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të sipërfaqeve takuese ndërtimore, të përcaktuara sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Bashkisë Durrës dhe zhvilluesit privat.
7. Çdo sipërfaqe ndërtimore e përfituar si rezultat i marrëveshjeve të sipërmarrjes/shkëmbimit përdoren vetëm për realizimin e funksioneve dhe përmbushjes së misionit të Bashkisë Durrës.
8. Ngarkohet kryetari i bashkisë dhe administrata e Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 03.04.2026**



BASHKIA DURRES  
9 4 26 4195/9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRES

Nr. 246/prot.  
11

Durrës, më 08.04.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRES

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRES

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.21 datë 02.04.2026, "Për miratimin e dhënies për zhvillim të pasurisë me nr. 25/40, e llojit "ndërtesë", me sipërfaqe 410 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale 8518, rruga "Pavarësia", lagjja nr. 13, Durrës, me qëllim shkëmbimin në natyrë për përfitimin e sipërfaqes ndërtimore ekuivalente ose më të madhe se objekti ekzistues".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ADRIAN GURRA

